



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2256 prot.

Ballsh, më 28 . 04 .2022

VENDIM

Nr. 23 Datë 27 / 04 / 2022

PËR

**ZHVARRIMIN DHE RIVARRIMIN E MBETJEVE MORTORE NË VARREZAT E
DËSHMORËVE TË ATDHEUT NË QYTETIN E BALLSHIT PËR TË NDJERIN
RAMAZAN MUHARREM METAJ DHE BEKTASH TAHIR SINAJ ,DËSHMOR TË
ATDHEUT**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, në zbatim të nenit 13 të ligjit nr.109/2018 “ Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”, të nenit 17 të ligjit nr.9220, datë 15.04.2004, i ndryshuar “ Për Shërbimin Publik të Varrimit”, Vendim nr.711, datë 29.10.2014 “ Për miratimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, si dhe bazuar në kërkesën Nr.1558, datë 24.03.2022 të Znj. Mbarime (Metaj) Shehaj dhe kërkesën Nr.1627, datë 28.03.2022 të Z.Bektash Sinaj ,

VENDOSI:

1. Zhvarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut Ramazan Muharrem Metaj nga varrezat e fshatit Greshicë, Njësia Administrative Greshicë, Mallakastër dhe rivarrimin e mbetjeve mortore në varrezat e dëshmorëve të atdheut në qytetin e Ballshit, Bashkia Mallakastër.
2. Zhvarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut Bektash Tahir Sinaj nga varrezat e fshatit Graçie, Njësia Administrative Qendër, Mallakastër dhe rivarrimin e mbetjeve mortore në varrezat e dëshmorëve të atdheut në qytetin e Ballshit, Bashkia Mallakastër.
3. Strukturat e Bashkisë Mallakastër të marrin masa për zhvillimin e ceremonisë zyrtare dhe homazhe në shenjë nderimi, përkujtimi dhe mirënjohje kombëtare për dëshmorët e atdheut të renë në kuadër të kontributit të luftës për liri, pavarësi, çlirim kombëtar dhe ruajtjen e integritetit territorial të shtetit Shqipëtar.
4. Vendi i rivarrimit të mbetjeve mortore do të përcaktohet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

KRYETAR

Mbarime Isufaj

